

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjykatëses së vetme gjykuese, Luljete Shabani, në lëndën penale kundër të akuzuarve N.E., F.E.1., dhe F.E.2, për shkak të veprës penale, Lëndimi i lehtë trupor, nga neni 188 par.3, nënpar.3.1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti i Përgjithshëm, PP.II. nr. 429/17, të datës 16.03.2017, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 22.11.2018, bie dhe në prezencë të palëve mori dhe publikoi, ndërsa më 27.11.2018 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari **N.E.**, nga babai S. dhe nëna Sh., e lindur H., i lindur më datë ... në fsh. ..., K. e ..., ku edhe jeton, i martuar, baba i tre fëmijëve, muzikant, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i dënuar më parë dhe nuk zhvillohet procedurë tjetër penale ndaj tij

I akuzuari **F.E.1.** nga babai N. dhe nëna R., e lindur V., i lindur më datë ... në ..., jeton në gsh. ..., K. e ..., i pamartuar, i papunë, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa dënuar më parë dhe nuk zhvillohet procedurë tjetër penale ndaj tij

Veçohet procedura penale ndaj të akuzuarit **F.E.2.**, për shkak se është jashtë Kosovës.

J A N Ë F A J T O R Ë

Sepse, më datën 09.03.2017, rreth orës 15.00 min., në fsh. Pidiq, K. e Gjilanit, afër shtëpisë së tyre, për shkak të një fjalosje të momentit, të tre të akuzuarit së bashku e kanë sulmuar dhe e kanë lënduar lehtë të miturin, tani të dëmtuarin L.A., nga po i njëjti fshat, në atë mënyrë që e kanë gopditur me shuplaka dhe grushte në kokë dhe këmbë, me ç'rast, i kanë shkaktuar lëndime të lehta trupore, në formë të ndrydhjeve, ajtjeve dhe qarjeve të indeve të buta të kokës dhe pjesëve të tjera të anës së djathtë të trupit, me pasoja të përkohshme për shëndetin,

-me çka në bashkëveprim si bashkëzekutorë kanë kryer veprën penale **Lëndimi i lehtë trupor**, nga neni 188 par. 3, nënpar. 1.3, lidhur me nenin 31 të KPRK-së,

I G J Y K O N M E D Ë N I M M E K U S H T

1. Të akuzuarin **N.E.**, me **Dënim Burgu** në kohëzgjatje prej **3 (tre) muajve**, i cili i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në kohën prej **1 (një) viti** nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën gjykata dënimin me kusht do ta revokojë.

2. Të akuzuarin **F.E.1.**, me **Dënim Burgu** kohëzgjatje prej **3 (tre) majve**, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në kohën prej **1 (një) viti** nuk kryen vepër tjetër penale, në të kundërtën gjykata dënimin me kusht do ta revokojë.

Obligohen të tre të akuzuarit që ta paguajnë paushallin gjyqësor në shumën prej **15 (pesëmbdhjetë) €**, secili veç e veç, si dhe shpenzimet e procedurës penale, sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, të gjitha këto në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur Aktakuzë PP. II. nr. 429/2017, të datës 16.03.2017, kundër të akuzuarve N., F.1. e F.2. E., për shkak të veprës penale, Lëndimi i lehtë trupor, nga neni 188 par. 3 nënpar.3.1, lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe ka kërkuar që të akuzuarit të shpallen fajtorë dhe të dënohen me dënim meritator sipas ligjit.

Për shkak se i akuzuari F.E.2. nuk është në Kosovë, ndaj tij është veçuar procedura penal dhe ka vazhduar për dy të akuzuarit e tjerë, N. e F.E.1..

dëmtuari L.A., gjithashtu nuk pati vërejtje në pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarve, deklaroi se nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale ndaj tyre, as nuk kërkon kompensim material, pasi që me ta janë pajtuar, meqenëse ata i kanë kërkuar falje, kanë marrëdhënje të mira, sepse janë kusherinj.

Gjykata e aprovoi pranimin e fajsisë nga ana e të akuzuarve, në bazë të nenin 248 par.4 i KPPRK-së, pasi që pranimi fajsisë është bërë në mënyrë vullnetare, pa u ndikuar nga askush, të njoftuar më parë për pasojat dhe benefitet e fajsisë, i cili pranim është në harmoni edhe me provat e tjera në shkresat e lëndës, andaj, nuk pati nevojë të shtjellojë prova të tjera..

Me rastin e caktimit dhe llojin e lartësisë së dënimit, Gjykata pati parasysh rrethanat e parapara me nenin 73 të KPRK-së dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se të akuzuarit janë penduar për veprën në fjalë, janë pajtuar dhe i kanë kërkuar falje të dëmtuarit, i cili nuk iu bashkëngjitet ndjekjes penale ndaj tyre as nuk kërkoi kompensim material, ndërsa, si rrethanë rënduese, mori shkallën e përgjegjësisë penale dhe rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale, me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 41 të KPRK-së.

*Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPPRK-së.
Nga të cekurat më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr. 252/17, më datë 27.11.2018**

**Gjykatësja e vetme gjykuese,
Luljete Shabani**

KËSHILLA JURIDIKE: *Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa dorëzohet në dy ekzemplarë, përmes kësaj Gjykate.*